



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



RAPORT I PROCESIT TARIFOR 2022-2024

SHËRBIMET E FURNIZIMIT ME UJË DHE SHËRBIMET E UJËRAVE TË NDOTURA

Prishtinë, shkurt 2022

PËRMBAJTJA

1	Përmbledhje ekzekutive	5
2	Roli dhe përgjegjësitë e ARRU	6
3	Qasja e ARRU në përcaktimin e tarifave	7
3.1	Historiku i proceseve tarifore	7
3.2	Politikat tarifore.....	7
3.3	Shqyrtimi i aplikacioneve të KRU nga ARRU	8
3.4	Konsultimi i aplikacioneve të dorëzuara me ofruesit e shërbimeve	8
3.5	Draft tarifave dhe diskutimet publike	10
4	Parimet e përcaktimit të tarifave.....	12
4.1	Zvogëlimi i Ujit të Pa-faturuar (UPF).....	12
4.2	Rritja e nivelit (përqindjes) së arkëtimit	12
4.3	Ndryshimi i koeficientit të ndër-subvencionimit të tarifave midis kategorive të konsumatorëve	13
4.4	Pragu minimal i investimeve kapitale në infrastrukturën e ujit dhe ujërave të ndotura	14
4.5	Mos ngritja e shpenzimeve operative të KRU-ve krahasuar me vitin 2021.....	15
4.6	Përmirësimi i treguesit të efikasitetit të personelit.....	15
5	Shqyrtimi i aplikacioneve të TARIFAVE	17
5.1	Komponentët përbërës të tarifës	17
5.2	Shpenzime operative	17
5.3	Investimet kapitale	18
5.4	Numri i konsumatorëve	21
5.5	Faturimi dhe shkalla e arkëtimit	22
6	PËRBALLUESHMËRIA E TARIFAVE	24
SH-1.	Shtojcat e raportit.....	26
SH-1.1.	Të dhënat operative	26
SH-1.2.	Të dhënat për numrin e konsumatorëve	27
SH-1.3.	Shpenzimet operative për ujë	28
SH-1.4.	Shpenzimet operative për ujëra të ndotura.....	29
SH-1.5.	Faturimi	30
SH-1.6.	Arkëtimi	31
SH-1.7.	Investimet kapitale vetjake për ujë	32
SH-1.8.	Investimet kapitale vetjake për ujëra të ndotura.....	33
SH-1.9.	Tarifat finale 2022-2024	34

Lista e tabelave

Tabela 1. Norma e zbërthyer e UPF	12
Tabela 2. Shtyrja e KRU-ve për zvogëlim të UPF-së për vitet 2022-2024	12
Tabela 3. Koeficienti i ndër-subvencionit për ujë	13
Tabela 4. Koeficienti i ndër-subvencionit për ujëra të ndotur	13
Tabela 5. Pragu minimal i investimeve kapitale	14
Tabela 6. Treguesi i efikasitetit të stafit (nr. i personelit/1000 konsumatorë)	15
Tabela 7. Efikasiteti i stafit në Kosovë dhe Regjion	15
Tabela 8. Investimet e aprovuara për shërbimet e ujit sipas kategorive	20
Tabela 9. Investimet e aprovuara për shërbimet e ujërave të ndotura sipas kategorive	20
Tabela 10. Planifikimi i faturimit në procesin tarifor 2022-2024	22
Tabela 11. Përballeshmëria e faturave të shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura	25

Lista e figurave

Figura 1. Foto e konsultimeve të draft aplikacioneve me KRU-të	10
Figura 2. Foto të diskutimeve publike	11
Figura 3. Alokimi i shpenzimeve	17
Figura 4. Alokimi i investimeve	18
Figura 5. Alokimi i investimeve	19
Figura 6. Alokimi i investimeve për ujë	21
Figura 7. Alokimi i investimeve për u.n	21
Figura 8. Kategorizimi i asetëve sipas udhëzimeve të kontabilitetit rregullator	21
Figura 9. Konsumatorët	22
Figura 10. Alokimi i faturimit	23
Figura 11. Konsumatorët sipas KRU-ve	23

Akronimet dhe shkurtesat

ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
BRrA	Baza Rregullatore e Aseteve
SDC	Swiss Development Cooperation – Zyra Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
FE	Kompania Rajonale e Ujësjetlësit Bifurkacioni (Ferizaj)
GJA	Kompania Rajonale e Ujësjetlësit (Gjakova)
GJI	Kompania Rajonale e Ujësjetlësit Hidromorava (Gjilan)
ITUN	Impiantet e Trajtimit të Ujërave të Ndotura
KRU	Kompania Rajonale e Ujit
MIT	Kompania Rajonale e Ujit Mitrovica (Mitrovicë)
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
PMA	Planet e Menaxhimit të Aseteve
PE	Kompania Rajonale e Ujësjetlësit Hidrodrini (Pejë)
PR	Kompania Rajonale e Ujësjetlësit Prishtina (Prishtinë)
PZ	Kompania Rajonale e Ujësjetlësit Hidroregjioni Jugor (Prizren)
UKRR	Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator
BPV	Bruto Produkti vendor
ASK	Agjencia Statistikore e Kosovës

1 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) është institucion i pavarur në kryerjen e funksioneve të tij sipas Ligjit Nr. 05/L -042 PËR RREGULLIMIN E SHËRBIMEVE TË UJIT, të shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 4/2016 datë 14.01.2016. Një ndër përgjegjësitë e ARRU-së është përcaktimi i tarifave të shërbimit për ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit në Kosovë.

Pas inicimit të procesit dhe pranimit të aplikacioneve nga të gjitha KRU-të, për përcaktimin e tarifave për vitet 2022-2024, ARRU ka shqyrtuar, analizuar dhe vlerësuar të dhënat e parashtruara në Biznes Planet Rregullatorë të çdo KRU, bazuar në politikat rregullatore të këtyre shërbimeve.

Brenda përgjegjësiave ligjore të ofruesit e shërbimeve janë udhëzuar që të bëjnë planifikime sa më reale të cilat i mundësojnë konsumatorëve që të kenë tarifa të drejta dhe të përballueshme.

Duke u bazuar në kërkesat e ofruesve të shërbimeve dhe sipas rekomandimeve nga diskutimet publike, me qëllim të vendosjes së ngarkesave tarifore të drejta, në mes të konsumatorëve shtëpiak dhe atyre jo shtëpiak, duke u bazuar në politikat tarifore, ARRU ka vendosur të reduktoj shkallën e ndër-subvencionimit për tarifën volumetrike të ujit.

Tarifat e shërbimeve të ujësjellësit për konsumatorët shtëpiak për vitin 2022 krahasuar me vitin 2021 janë të njëjta tek KRU "Hidroregjioni-Jugor", KRU "Hidrodrini" dhe KRU "Gjakova". Tek KRU-të tjera ka rritje të vogël të tarifave. KRU "Bifurkacioni" nga fillimi i vitit 2022 do të marrë në menaxhim Impiantin e ri të Përpunimit të Ujit (IPU) në fshatin Talinoc, i financuar përmes kredisë nga Komuna e Ferizajt. Kjo ka ndikuar në rritjen e tarifës, nga 0.35 €/m³ sa ishte në vitin 2021 në 0.37 €/m³. Në anën tjetër NHE "Ibër Lepenci" ka marrë kredi për rehabilitim të kanalit sipërfaqësor, kjo kredi është reflektuar në rritjen e tarifës për KRU "Prishtina" dhe "Mitrovica" që blejnë ujin me shumicë nga NHE "Ibër Lepenci". Për KRU "Prishtina" tarifa për ujë nga 0.43 €/m³ sa ishte në vitin 2021 është shtrenjtuar në 0.44 €/m³ për vitin 2022. Ndërkaq, te KRU "Mitrovica" ka rezultuar në rritje të tarifës nga 0.34 €/m³ sa ishte në vitin 2021 në 0.36 €/m³ për vitin 2022. Duhet pasur parasysh se tarifën e KRU "Mitrovica" për vitin 2022 janë të njëjta me ato që kanë qenë në vitin 2020.

Tarifa e shërbimeve të ujësjellësit tek KRU "Hidromorava" është rritur nga 0.34 €/m³ sa ishte në vitin 2021 në 0.35 €/m³ në vitin 2022, si rrjedhojë e ndryshimit të koeficientit të ndër-subvencionimit si dhe marrjes nën menaxhim të sistemeve rurale që ndikon në rritjen e shpenzimeve operacionale për operim të këtyre sistemeve.

Si rezultat i zvogëlimit të koeficientit të ndër-subvencionimit, tek të gjitha KRU-të kemi zvogëlim të tarifave volumetrike për shërbimet e ujësjellësit, për konsumatorët jo shtëpiak, përveç KRU "Bifurkacioni".

Pas futjes në operim të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura në KRU "Gjakova" dhe KRU "Hidrodrini" ka ndikuar që tarifën e ujërave të ndotura për konsumatorët shtëpiak të rriten nga 0.07 €/m³ në 0.14 €/m³ për vitin 2022.

Në këtë raport është analizuar edhe përballueshmëria e pagesës së faturave nga konsumatorët me të ardhura të ulëta. Pjesëmarrja e faturës mesatare për shërbimet e ujit në Kosovë në pagën mesatare është 2.27% për vitin 2021, afërsisht e njëjtë është edhe për vitin 2022, pas hyrjes në fuqi të tarifave të reja.

2 ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E ARRU

Roli i ARRU-së si rregullator ekonomik për sektorin e furnizimit me ujë dhe shërbimeve të ujërave të ndotura është për të siguruar që ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit, nuk keqpërdorin pozitën e tyre monopoliste, duke u siguruar që ato të ofrojnë një standard të pranueshëm të shërbimit të përcaktuar sipas kushteve të licencës, me tarifa të arsyeshme dhe se të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella të ofruesve të shërbimit dhe konsumatorëve janë të balancuara në mënyrë të drejtë dhe të njëjtat zbatohen. Për këtë arsye ARRU në kuadër të mandatit të saj ka ndërmarrë këto aktivitete kryesore:

- Përcaktimin e tarifave në nivele të mjaftueshme për ofruesit e shërbimeve për të financuar aktivitetet e tyre në përputhje me standardet e obligueshme të shërbimit dhe në nivel të pranueshëm të pritjeve për shërbime, sigurimin e qëndrueshmërisë financiare të ofruesve të shërbimeve duke promovuar eficiencën në punë;
- Licencimin e ofruesve të shërbimeve të furnizimit me ujë, shërbimeve të ujërave të ndotura dhe furnizimit të ujit me shumicë;
- Stimulimin e konkurrencës midis ofruesve të shërbimit përmes krahasimit (bechmarking) si dhe raportimit të rregullt të performancës në baza periodike dhe atë vjetore;
- Inspektimi i përmbushjes së standardeve të shërbimit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të akteve ligjore të ARRU;
- Mbrojtjen e interesave të konsumatorëve duke siguruar që ofruesit e licencuar të shërbimeve nuk keqpërdorin pozitën e tyre monopoliste duke siguruar njëkohësisht që shërbimet e ofruara të jenë në përputhje me standardet e vendosura;

Në pajtim me praktikën e mira rregullatore, qasja e ARRU-së është e orientuar drejt rezultateve konkrete. Kryesisht fokusi ishte tek përmbushja e standardeve të shërbimit, monitorimi i shpenzimeve operative dhe kapitale dhe ngritja e eficiencës së ofruesve të shërbimeve të ujit.

3 QASJA E ARRU NË PËRCAKTIMIN E TARIFAVE

3.1 Historiku i proceseve tarifore

Para vitit 2009 tarifat e furnizimit me ujë dhe tarifat për ujërat e ndotura përcaktoheshin çdo vit mbi bazën e të dhënave historike financiare, e që përdorshin si përcaktues kryesor i nevojave financiare për vitin pasues. Kjo metodologji tarifore nuk ka marrë parasysh objektivat zhvillimore afat mesme dhe afat gjatë të sektorit, nuk ka nxitur dhe stimuluar efikasitetin financiar dhe operues të ofruesve dhe ka krijuar pasiguri që i ka dekurajuar investitorët/ donatorët e sektorit të ujit.

Para vitit 2009 tarifat e furnizimit me ujë dhe tarifat për ujërat e ndotura përcaktoheshin çdo vit mbi bazën e të dhënave historike financiare, e që përdorshin si përcaktues kryesor i nevojave financiare për vitin pasues. Ky proces mori parasysh pak ose aspak objektivat e ardhshme të zhvillimit të sektorit (dhe se si do të financoheshin ato), bëri shumë pak për të nxitur eficientësinë financiare dhe operacionale dhe ka krijuar pasiguri që i ka dekurajuar investitorët.

Në vitin 2008 ARRU ka aplikuar procesin e parë të shqyrtimit tre vjeçare të tarifave (2009-2011), të mbështetur nga asistencë teknike ndërkombëtare, i cili proces ishte i bazuar në projeksione largpamëse të shpenzimeve, investimeve kapitale dhe lejimit për kthim në kapital të mjaftueshëm për të ripërtërirë infrastrukturën e ujit dhe ujërave të ndotur, duke pasur parasysh gjithmonë përbalueshmërinë e pagesës së faturave nga konsumatorët. Tarifat ishin vendosur paraprakisht mbi nivelet e çmimeve të vitit bazë (2008) për tre vitet e periudhës së shqyrtimit 2009-2010-2011.

Në vitin 2011 në bashkëpunim me konsulentë ndërkombëtarë është avancuar edhe më tej procesi tarifor (2012-2014) duke zhvilluar një Biznes Plan Rregullator (BPRR) i cili ishte shumë i lehtë për t'u përdorur dhe është avancuar baza e raportimit të dhënave.

Procesi tarifor 2015-2017 ishte vazhdimësi e procesit tarifor 2012-2014, me disa ndryshime të vogla në BPRR, përshtatja e tarifave me inflacion si dhe përfshirja e normës së kthimit në kapital. E tëra, është udhëhequr, organizuar dhe përmbyllur nga stafi i ARRU.

Edhe procesi tarifor 2018-2020 ka qenë vazhdimësi e procedurave të zhvilluara deri në këtë kohë për përcaktimin e tarifave. Janë shfrytëzuar modelet softuerike ekzistuese dhe nuk ka pasur ndonjë ndryshim të theksuar mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave.

Me qëllim të mbrojtjes të jetës dhe shëndetit të zyrtarëve publik dhe qytetarëve, si pasojë e rrethanave të krijuara nga pandemia Covid-19, në vitin 2020 ARRU ka nxjerrë vendim që tarifat e shërbimeve të ujësjellësit dhe të ujërave të ndotura të aprovohen për periudhën një vjeçare që do të ishin të aplikueshme për vitin 2021. Në këtë proces tarifor nuk ka pasur ndonjë analizë të mirëfilltë të dhënave financiare dhe operative të ofruesve të shërbimeve.

Gjatë vitit 2021 ARRU ka vazhduar punën me Procesin Tarifor, njësoj si në proceset paraprake tarifore dhe ka përcaktuar tarifa tre vjeçare, për vitet 2022-2023-2024, të bazuara në metodologjinë aktuale të kalkulimit të tarifave.

3.2 Politikat tarifore

Përbrenda kornizës së përgjithshme të procesit për përcaktimin e tarifave ARRU ka hartuar *'Politikat Tarifore për Shërbimet e furnizimit me ujë, shërbime të ujërave të ndotura dhe shërbime të shitjes së ujit me shumicë'*. Politikat kryesore që përfshihen në këtë dokument janë:

- Për secilën KRU tarifrat duhet të jenë uniforme në tërë zonën e saj të shërbimit dhe për secilin grup të konsumatorëve.
- Ndër-subvencionimi ekzistues i tarifës së konsumatorëve shtëpiak nga ata jo-shtëpiak për shërbimet e furnizimit me ujë duhet që gradualisht të reduktohet deri sa të barazohet.
- Për shërbimet me ujëra të ndotura dallimi ekzistues në mes të tarifave të konsumatorëve jo-shtëpiak dhe atyre shtëpiak duhet të ekzistojnë, sepse konsumatorët jo-shtëpiak gjenerojnë më shumë ndotje të ujërave se konsumatorët shtëpiak.
- Tarifrat duhet të jenë të mjaftueshme për të mirëmbajtur qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve.
- KRU-ve iu lejohet përfitimi nga kthimi në bazën rregullatore të aseteve të tyre, në atë masë që të financojnë investimet kapitale në infrastrukturën që e operojnë.

3.3 Shqyrtimi i aplikacioneve të KRU nga ARRU

Roli i ARRU-së është për të balancuar interesat e konsumatorëve me nevojën për të ruajtur integritetin financiar të KRU-së dhe, kërkon shqyrtim të hollësishëm të aplikacioneve tarifore të KRU. Ne e kemi për detyrë që të sigurojmë që KRU të operojnë në mënyrën më efikase të mundshme, e kjo për të siguruar që konsumatorët nuk paguajnë më as më shumë e as më pak se që është e nevojshme. Megjithatë dihet se nivel ideal i eficiencës nuk mund të arrihet edhe aq shpejtë, për këtë arsye ARRU ka venë caqe për të sfiduar ofruesit e shërbimeve me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të standardeve të shërbimit dhe ngritjes së eficiencës së operimit.

ARRU ka qenë e vëmendshme, që të mos lejojë KRU-të të rrisin shpenzimet operative krahasuar me vitin 2020/2021, përveç rasteve kur KRU-të kanë pasur arsyetime të dokumentuara, si p.sh. kthimi i kredive për impiantet e financuara me hua-marrje, futja në operim i impianteve të reja për përpunimin e ujit të pijshëm si dhe futja në operim e impianteve të reja për përpunimin e ujërave të ndotura, etj.

Përmes procesit tarifor 2022 – 2024 ARRU është fokusuar që KRU-të të dedikojnë më tepër mjete financiare në pjesën e investimeve kapitale. Në këtë kontekst, secila KRU është e obliguar që të arrijë një vlerë minimale të investimeve kapitale prej burimeve vetjake në infrastrukturën e ujit të pijshëm, që është ekuivalente me 10 Euro/konsumatorë/vit dhe 4 Euro/konsumatorë /vit në infrastrukturën e ujërave të ndotura.

Gjatë procesit të shqyrtimit të aplikacioneve tarifore, ARRU i ka kushtuar vëmendje integritetit financiar të KRU dhe në veçanti statusit të tyre financiar të parë nga prizmi e investitorëve, sidomos komunitetit të donatorëve dhe kreditorëve ndërkombëtar të involvuar në sektorin e ujit. Sektori i ujit në Kosovë (KRU, Qeveria dhe ARRU) duhet të tregojnë se janë serioz dhe ambicioz në lidhje me përmirësimin e shërbimeve në sektorin e ujit dhe janë të gatshëm për të marrë vendime të vështira.

Theks i veçantë i është kushtuar përballeshmërisë për pagesë të faturave nga ana e konsumatorëve krahasuar me të hyrat mesatare të ekonomive familjare në Kosovë. Mbështetur në pagën mesatare në Kosovë për vitin 2021, përqindja e pjesëmarrjes së ngarkesës së faturës për ujë është vetëm 2.27 %.

3.4 Konsultimi i aplikacioneve të dorëzuara me ofruesit e shërbimeve

ARRU ka insistuar vazhdimisht që KRU-të të dorëzojnë aplikacionet e tyre sipas afateve kohore të parapara në kalendarin rregullator. Pas pranimit të versioneve të para të aplikacioneve për tarifa, ka filluar

puna intensive në ARRU për të analizuar këto aplikacione nga aspekti i kompletueshmërisë administrative dhe plotësimit të dhënave në BPRR, që paraqet analizën preliminare të aplikacioneve.

Gjatë analizës preliminare të aplikacioneve, ARRU ka zbatuar parimet e sfidimit të ofruesve përmes vendosjes së parimeve për caqet që duhet të arrihen nga ofruesit e shërbimeve. Këto parime janë përshkruar në detaje në Kapitullin 4 të këtij raporti, e që konsistojnë në sfidimin e ofruesve për sa i përket: zvogëlimin të humbjeve të ujit, rritjen e shkallës së arkëtimit, mirëmbajtja ose zvogëlimi i shpenzimeve operative, realizimi i investimeve kapitale, rritja e efikasitetit të stafit apo ulja e normës së stafit për 1000 konsumatorë, koeficienti i ndër-subvencionimit të tarifave për të gjithë ofruesit është aprovuar të jetë i njëjtë, etj.

Pas plotësimit të dhënave të munguara në metodologjinë tarifore, ajo është prezantuar tek të gjitha KRU-të veç e veç për të bërë propozimin e parë të Biznes Planit Rregullator (BPRR).

Pas këtyre takimeve dhe pajtueshmërisë nga KRU-të janë organizuar diskutime publike në mënyrë që publiku i gjerë dhe palët tjera të interesit të njoftohen për së afërmi me procesin tarifor dhe me të dhënat që e karakterizojnë secilin aplikacion tarifor. Fotot nga takimet me KRU-të janë dhënë në vijim.



Figura 1. Foto e konsultimeve të draft aplikacioneve me KRU-të

3.5 Draft tarifrat dhe diskutimet publike

Bazuar në nenin 4, paragrafi 3.2 të Ligjit Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe Kreut V të Rregullores Nr.12/2020 për Përcaktimin e Tarifave për Shërbimet e Ujit në Kosovë me qëllim të përcaktimit të tarifave për shërbimet e ujit, ARRU ka mbajtur diskutime publike në 7 qendrat kryesore të zonës së shërbimit të KRU-ve në Kosovë. Në këto diskutime publike janë ftuar palët e interesit, si: konsumatorët e zonës respektive të shërbimit, mediat, organizatat joqeveritare, etj.

Prezenca fizike në këto diskutime publike ishte relativisht e vogël, mbase si pasojë e rrethanave të krijuara nga pandemia COVID-19, megjithatë ARRU në raste të tilla ka mbajtur “live stream” përmes rrjeteve sociale ku është bërë e mundur shkëmbimi i pyetjeve dhe përgjigjeve. Në këto takime publike, konsumatorët dhe palët e interesit, kanë shprehur opinionin e tyre rreth ngarkesës së faturës së ujit dhe për të gjitha çështjet që kishin të bënin me aplikacionin tarifor.

As përmes opsionit “live stream” në adresë të ARRU nuk ka pasur reagime rreth ngarkesës së faturës për shërbime të ujit. Po ashtu në ARRU asnjëherë nuk ka pasur ankesë rreth lartësisë së faturave. Në fotot më poshtë janë paraqitur aktivitetet e ndërmarra gjatë diskutimeve publike.





Figura 2. Foto të diskutimeve publike

4 PARIMET E PËRCAKTIMIT TË TARIFAVE

4.1 Zvogëlimi i Ujit të Pa-faturuar (UPF)

Niveli i UPF është shumë i lartë dhe i ndryshëm nëpër ofrues shërbimesh, kjo nënkupton se KRU-të që kanë nivel më të lartë të UPF mund të bëjnë progres më të madh në zvogëlimin e UPF, ndërsa KRU-të me nivel më të ulët të UPF kanë potencial më të vogël të zvogëlojnë UPF. Prandaj, duke pasur parasysh këtë fakt, si dhe duke marrë për bazë edhe komentet e dhëna nga palët e interesit, ARRU e konsideron të arsyeshme që shtyrja e KRU-ve, kundrejt zvogëlimit të përqindjes së lartë të UPF, të bëhet me normë të zbërthyer, sipas tabelës në vijim:

Tabela 1. Norma e zbërthyer e UPF

Norma e zbërthyer e UPF	Shkalla e zvogëlimit të UPF për një vit
>55%	4.0%
>50% - ≤55%	3.0%
>45% - ≤50%	2.5%
>40% - ≤45%	2.0%
>35% - ≤40%	1.5%

Vlerë referente për humbjet e ujit është marrë niveli i UPF në vitin 2020, në këtë kontekst në tabelën 2 janë përcaktuar vlerat e UPF të cilat duhet të arrihen nga KRU-të përgjatë procesit tarifor 2022-2024. Këto vlera do të monitorohen dhe do të kërkohet që me përpikëri të përmbushen.

Tabela 2. Shtyrja e KRU-ve për zvogëlim të UPF-së për vitet 2022-2024

KRU	Të dhënat e realizuara dhe audituara	Planifikimi/ projeksioni (të dhënat e aprovuara nga ARRU)			
	2020	2022	2023	2024	Totali për 3 vite
PR	58%	54%	51%	48%	6%
PZ	55%	51%	48%	46%	6%
PE	60%	56%	52%	49%	7%
MIT	53%	49%	47%	44%	5%
GJA	42%	38%	36%	35%	3%
FE	64%	60%	56%	52%	8%
GJI	47%	43%	41%	39%	4%

4.2 Rritja e nivelit (përqindjes) së arkëtimit

Për procesin tarifor 2022-2024, ARRU ka vendosur për të ngritur pragun e arkëtimit për dy kategoritë e konsumatorëve, duke sfiduar KRU-të që të jenë më efikase në arkëtim, nënshkrimin e kontratave dhe komunikimin më të afërt me konsumatorët. Në këtë proces tarifor është aprovuar që pragu i shkallës së arkëtimit të jetë si në vijim:

- Për konsumatorët shtëpiak është aprovuar ngritja e shkallës së arkëtimit në 92%,
- Për konsumatorët biznes/ industri/ institucione shkalla e arkëtimit është aprovuar të jetë 100%.

Përfundim nga ky rregull bën vetëm KRU Mitrovica, që për shkak të situatës aktuale politike dhe gjendjes sociale të rënduar, arkëtimi është aprovuar të jetë 81%-83%-84% për periudhën 2022-2023-2024, ndërsa për biznese/ industri/ institucione shkalla e arkëtitimit është aprovuar të jetë 100%.

4.3 Ndryshimi i koeficientit të ndër-subvencionimit të tarifave midis kategorive të konsumatorëve

Që nga fillimi i përcaktimit të tarifave, ARRU ka aplikuar formulën e ndër-subvencionimit të tarifës së konsumatorëve shtëpiak nga konsumatorët biznes/ industri/ institucione, që është praktikë e shumicës së shteteve të regjionit. Në anën tjetër është praktikë e përgjithshme gjithandej nëpër botë që për produkt të njëjtë dhe sasi të njëjtë (siç është uji) të paguhet shumë e njëjtë nga të gjitha kategoritë e konsumatorëve, pra kostoja volumetrike të jetë e njëjtë për të gjithë kategoritë e konsumatorëve. Në këtë kontekst, ARRU ka aplikuar një ulje të vazhdueshme të koeficientit të ndër-subvencionimit. Koeficienti i ndër-subvencionimit për tarifën e ujit të pijshëm përgjatë viteve është dhënë në tabelën 3.

Tabela 3. Koeficienti i ndër-subvencionit për ujë

Nr.	KRU	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022-2024
1	PR	2.2	2.2	2.2	2.0	1.8	1.6	1.6	1.5
2	PZ	1.9	1.9	1.9	1.8	1.8	1.8	1.8	1.5
3	PE	2.0	2.0	2.0	1.8	1.8	1.8	1.8	1.5
4	MIT	2.1	2.1	2.0	2.0	1.8	1.6	1.6	1.5
5	GJA	2.0	2.0	2.0	1.8	1.8	1.8	1.8	1.5
6	FE	2.0	2.0	2.0	2.0	1.8	1.6	1.6	1.5
7	GJI	2.0	1.9	1.9	2.0	1.8	1.6	1.6	1.5

Për ujërat e ndotura tarifa e ndër-subvencionimit është mbajtur në nivelin 2.2 për periudhën 2022-2024, për periudhën 2015-2024, vlera e koeficientit të ndër-subvencionimit është treguar në tabelën 4.

Tabela 4. Koeficienti i ndër-subvencionit për ujëra të ndotur

Nr.	KRU	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022-2024
1	PR	2.3	2.3	2.2	2.2	2.2	2.2	2.2	2.2
2	PZ	1.9	1.9	1.9	2.2	2.2	2.2	2.2	2.2
3	PE	2.0	2.0	2.0	2.2	2.2	2.2	2.2	2.2
4	MIT	2.5	2.5	2.5	2.2	2.2	2.2	2.2	2.2
5	GJA	2.5	2.5	2.5	2.2	2.2	2.2	2.2	2.2
6	FE	2.4	2.4	2.4	2.2	2.2	2.2	2.2	2.2
7	GJI	2.6	2.6	2.6	2.2	2.2	2.2	2.2	2.2

Koeficienti më i lartë i ndër-subvencionimit për ujërat e ndotur është marrë nën supozimin se kategoria e konsumatorëve biznes/ industri/ institucione kanë potencial më të lartë të ndotjes së ujërave të shkarkimit, prandaj shkarkimi dhe trajtimi i tyre është më i kushtueshëm.

4.4 Pragu minimal i investimeve kapitale në infrastrukturën e ujit dhe ujërave të ndotura

ARRU përmes procesit tarifor 2022 – 2024 ka dashur të fokusohet dhe të bëjë presion ndaj KRU-ve që të dedikojnë më tepër mjete financiare në pjesën e investimeve kapitale. Qëllimi është investimi në ripërtëritjen e asetëve dhe tranzicioni nga “varësia prej subvencioneve dhe ndihmave prej donatorëve” në “vet qëndrueshmëri”, pra krijimin e kulturës së investimeve në infrastrukturë nga burimet vetjake të KRU-ve. Për këtë qëllim në strukturën e propozuar tarifore 2022-2024 janë përfshirë edhe projektet për investime kapitale.

Në këtë kontekst, secila KRU është e obliguar që të arrijë një vlerë minimale të investimeve kapitale në infrastrukturën e ujit të pijshëm, që është ekuivalente me 10 Euro/konsumatorë dhe 4 Euro/konsumatorë në infrastrukturën e ujërave të ndotur. Për KRU-të individuale lartësia e investimeve kapitale nga burimet vetjake që është aprovuar me këtë proces tarifor është treguar në tabelën 5:

Tabela 5. Pragu minimal i investimeve kapitale

		Njesia	2022	2023	2024
Pr	Ujë	€	1,563,100	1,275,600	1,616,600
	Ujëra te ndotura	€	290,500	228,000	597,000
	Totli	€	1,853,600	1,503,600	2,213,600
Pz	Ujë	€	581,200	653,500	677,000
	Ujëra te ndotura	€	197,000	197,000	197,000
	Totli	€	778,200	850,500	874,000
Pe	Ujë	€	855,000	866,400	865,500
	Ujëra te ndotura	€	50,000	50,000	50,000
	Totli	€	905,000	916,400	915,500
Mit	Ujë	€	390,000	390,000	390,000
	Ujëra te ndotura	€	150,000	150,000	150,000
	Totli	€	540,000	540,000	540,000
Gja	Ujë	€	988,039	978,392	937,480
	Ujëra te ndotura	€	199,389	207,900	196,000
	Totli	€	1,187,428	1,186,292	1,133,480
Fe	Ujë	€	311,990	311,990	311,990
	Ujëra te ndotura	€	113,000	130,000	112,928
	Totli	€	424,990	441,990	424,918
Gjil	Ujë	€	335,530	335,530	335,530
	Ujëra te ndotura	€	114,112	116,112	116,112
	Totli	€	449,642	451,642	451,642
Sektori	Ujë	€	5,024,859	4,811,412	5,134,100
	Ujëra te ndotura	€	1,114,001	1,079,012	1,419,040
	Totli	€	6,138,860	5,890,424	6,553,140

Edhe te ky kriter, ARRU ka në plan që të rrisë në vazhdimësi pjesëmarrjen e investimeve kapitale nga buxheti vetjak i KRU-ve, e veçanërisht investimet në infrastrukturën më kritike, duke u bazuar në planin e menaxhimit të asetëve dhe planin e biznesit të KRU-ve.

ARRU është e përkushtuar që të monitorojë në mënyrë rigoroze implementimin e investimeve kapitale sipas listës së projekteve të propozuara nga KRU-të dhe, ky buxhet nuk do të lejohet të

shpenzohet apo përdoret për qëllime të tjera, përndryshe KRU-të do të ndëshkohen në proceset e ardhshme tarifore.

4.5 Mos ngritja e shpenzimeve operative të KRU-ve krahasuar me vitin 2021

ARRU ka qenë shumë këmbëngulës që të mos lejojë KRU-të të rrisin shpenzimet operative krahasuar me dy vitet paraprake 2020 dhe 2021, përveç rasteve kur KRU-të kanë pasur arsytetime të dokumentuara, si p.sh. kthimi i kredive për impiantet e financuara me hua-marrje, futja në operim i impianteve të reja për përpunimin e ujit të pijshëm apo impianteve për përpunimin e ujërave të ndotura, etj.

4.6 Përmirësimi i treguesit të efikasitetit të personelit

Gjatë procesit tarifor 2022-2024 i është kushtuar vëmendje e theksuar edhe treguesit për efikasitetin e stafit “numri i personelit/1000 konsumatorë” nëpër KRU. Në disa KRU ky tregues është i kënaqshëm, por te disa është tejet i lartë që tregon mbi-punësim dhe rëndim i pa nevojshëm mbi tarifën e shërbimit. Të dhënat e efikasitetit të stafit për vitet 2015-2021 dhe projeksioni i këtij treguesi i aprovuar përmes këtij procesi tarifor 2022-2024 është dhënë në tabelën në vijim:

Tabela 6. Treguesi i efikasitetit të stafit (nr. i personelit/1000 konsumatorë)

Nr	KRU	Ekzistuese							Projeksioni		
		2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
1	PR	4.8	4.4	4.1	4.4	4.1	3.8	na	3.5	3.6	3.5
2	PZ	7.2	7.2	7.0	6.7	6.6	6.4	na	6.7	6.4	6.3
3	PE	5.0	4.8	4.7	4.5	4.4	4.3	na	4.7	4.8	4.8
4	MIT	8.6	8.4	8.1	7.7	7.4	6.4	na	5.7	5.7	5.7
5	GJA	8.2	7.8	7.5	7.1	7.0	6.9	na	6.9	6.7	6.4
6	FE	7.9	7.8	7.7	7.0	6.8	6.5	na	6.7	6.4	6.2
7	GJI	6.8	5.5	5.7	5.5	5.2	4.7	na	4.3	4.2	4.1

Rritja e numrit të stafit në KRU “Hidroregjioni Jugor” Prizren, KRU “Hidrodrini” Pejë dhe KRU “Gjakova” Gjakovë vjen si pasojë e futjes në operim të impianteve të përpunimit të ujërave të ndotura (IPUN), që kanë pasur nevojë të shtimit të numrit të operatorëve. Tek KRU “Bifurkacioni” Ferizaj ka pasur shtim të personelit për shkak të planifikimit të futjes në operim të dy impianteve të ujit të pijshëm në Ferizaj dhe Han të Elezit. Tek KRU “Prishtina”, “Hidromorava” dhe “Mitrovica” ka një trend të zvogëlimit të stafit, që nënkupton rritje të efijencës së personelit. Krahasimi i këtij treguesi me shtetet e tjera të regjionit është si në vijim:

Tabela 7. Efikasiteti i stafit në Kosovë dhe Regjion

Vendet e Rajonit	Viti	Efikasiteti i stafit/ 1000 konsumatorë
Kosova	2020	5.1
Shqipëria	2020	5
Maqedonia e Veriut	2016	3
Mali i zi	2020	5

Bosnja e Hercegovina	2020	7
Serbia	2020	4
Kroacia	2015	3

5 SHQYRTIMI I APLIKACIONEVE TË TARIFAVE

5.1 Komponentët përbërës të tarifës

Qasja e ARRU-së gjatë përcaktimit të tarifave është të sigurojë që KRU-të të jenë në gjendje për të financuar aktivitetet e tyre në përputhje me standardet e përcaktuara të shërbimit përfshirë kthimi i 'drejtë' në kapital i parasë që KRU-të kanë investuar nga të hyrat vetjake.

Tarifa përcaktohet 'nga kërkesa për të ardhura' pjesëtuar me vëllimin e ujit të shitur (përshtatur për eficientë në arkëtimin e të ardhurave). Kërkesa për të ardhura është e përbërë nga tre komponentë kryesorë:

- Shpenzimet operative,
- Mirëmbajtja kapitale e përbërë nga:
 - Përtëritjet infrastrukturore (financimi i domosdoshëm për të ruajtur shërbyeshmërinë e aseteve infrastrukturore/ nëntokësore), dhe
 - Zhvlerësimi sipas kostos aktuale për asetet jo-infrastrukturore (kryesisht ato mbi tokësore).
- Kthimi në Bazën Rregullatore të Aseteve.

5.2 Shpenzime operative

Shpenzimet operative bazuar në rregulloren për përcaktimin e tarifave janë ndarë në dy kosto qendra edhe atë në:

- Shpenzimet operative për shërbimet e ujit dhe
- Shpenzimet operative për shërbimet e ujërave të ndotura

Gjatë procesit të aprovimit të BPRR për KRU-të, shpenzimet operative për vitet 2022, 2023 dhe 2024 si pikë referuese kanë pasur të dhënat e realizuara nga KRU-të në vitin 2020, dhe pa ndonjë arsye bindëse, këto shpenzime nuk është pranuar të rriten. Duke pasur parasysh kriterin e sipërm, ARRU ka qenë shumë e kujdesshme gjatë aprovimit të shpenzimeve operative për shërbimet e ujit dhe të shërbimeve të grumbullimit dhe të trajtimit të ujërave të ndotura.




Figura 3 Alokimi i shpenzimeve

Gjithsej për tri vitet e procesit tarifar në nivel të sektorit ARRU ka aprovuar shpenzime për ujë dhe ujëra të ndotura në vlerë prej 94,538,932 € ose mesatarisht për një vit shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të ndotura kapin vlerën prej 31,512,977 €.

Nga kjo vlerë mesatare prej 31,512,977 €, pjesëmarrja e shpenzimeve mesatare vjetore për shërbimet e ujit janë në vlerë prej 26,876,183 € ose 85%, kurse pjesa tjetër në vlerë prej 4,636,974 € ose 15% janë shpenzime për ujëra të ndotura.

Për arsye të monitorimit si dhe planifikimit më analitik shpenzimet e furnizimit me ujë i kemi ndarë në tri kosto qendra.

- Resurse dhe trajtim,

- Distribuim, si dhe
- Aktivitete biznesore ose shpenzimet e përbashkëta.

Në vlerën e shpenzimeve mesatare për shërbimet e ujit, shpenzimet për resurse dhe trajtim marrin pjesë me 32%, shpenzimet në distribuim marrin pjesë me 30% dhe pjesa e mbetur prej 38% janë shpenzimet në aktivitete biznesore (shpenzime të përbashkëta).

Për shërbimet e ujërave të ndotura, referuar tabelës 6.4, për sektorin mesatarisht janë aprovuar 4,636,794 € në baza vjetore për vitet 2022, 2023 dhe 2024 .

Shpenzimet për ujëra të ndotura janë ndarë në katër kosto qendra:

- Grumbullimi i ujërave të ndotur,
- Trajtimi i ujërave të ndotur,
- Trajtimi i llumit, dhe
- Aktivitete biznesore ose shpenzimet e përbashkëta.

Pjesëmarrja e shpenzimeve për ujëra të ndotur sipas kosto qendrave të paraqitura më lartë është: 38% për grumbullim të ujërave të ndotura, 17% për trajtimin e ujërave të ndotur, 14% për trajtimin e llumit dhe 31% për aktivitete biznesore.

Duhet pasur parasysh se tek shpenzimet e ujërave të ndotura, kosto qendra trajtim i ujërave të ndotura dhe trajtimi i llumit kanë pjesëmarrje më të vogël në totalin e shpenzimeve për ujëra të ndotur, sepse vetëm një fraksion shumë i vogël i ujërave të grumbulluara trajtohet edhe më pak bëhet trajtimi i llumit. Me ndërtimin e impianteve të reja për trajtim të ujërave të ndotura gradualisht do të rritet edhe pjesëmarrja në shpenzimet e ujërave të ndotura për shpenzimet e trajtimit të UN dhe shpenzimet e trajtimit të llumit.

5.3 Investimet kapitale

5.3.1 Investimet e aprovuara

KRU-të nuk kanë arritur të hartojnë plane të mirëfillta të menaxhimit të aseteve. Lista e investimeve të dorëzuara në ARRU për procesin tarifor, megjithatë, paraqet një plan të shtrirjes dhe shpërndarjes së investimeve kapitale, por që nuk përmban ndonjë analizë më të thellë për gjendjen dhe kritikitetin e aseteve.

Shuma e investimeve kapitale prej burimeve vetjake të financimit kap vlerën prej rreth 18 milion euro për tre vite, ku afër 80% prej tyre janë të destinuara për shërbimet e ujësjellësit, e vetëm 20% janë planifikuar për shërbimet e ujërave të ndotura.

Shikuar në vlera mesatare vjetore, sektori ka planifikuar të investojë rreth 4.8 milion euro në infrastrukturën e shërbimit të ujit dhe rreth 1.2 milion euro në infrastrukturën e ujërave të ndotura.

Për këtë proces tarifor, ashtu si edhe në procesin e kaluar tarifor 2018-2020, ARRU ka marrë të dhënat për secilin projekt të aprovuar, ku dihen shënimet si:

- Emri i projektit;
- Aryseshmëria e projektit;
- Paramasa dhe paralogaria e thjeshtë;
- Vlera financiare dhe burimi i financimit.




Figura 4. Alokimi i investimeve

Këto projekte të aprovuara nga ARRU, do të jenë subjekt vlerësimit për realizimin e tyre, dhe për këtë ARRU do të ndërmarrë aktivitete shtesë për t'i inspektuar dhe kontrolluar këto investime që kanë ndikim në përmirësimin e nivelit të shërbimit si dhe në lartësinë e tarifës.

Për më tepër, do të vazhdojë edhe puna e matjes së realizimit të caqeve të përcaktuara me këtë proces tarifor ku theks i veçantë do të vihet në rrafshin e realizimit të investimeve kapitale.




Figura 5. Alokimi i investimeve

5.3.2 Klasifikimi i investimeve sipas UKRR

Sipas Udhëzimit të Kontabilitetit Rregullator (UKRR), investimet kapitale janë klasifikuar si investime në shërbimet ujësjellësit dhe shërbimet e ujërave të ndotura.

- Investimet në shërbimet e ujësjellësit, më tej kategorizohen në:
 - Investime në resurse dhe trajtim të ujit,
 - Investime në distribuim, dhe
 - Investime në aktivitete biznesore.
- Investimet në shërbimet e ujërave të ndotura:
 - Investime në grumbullimin e ujërave të ndotura,
 - Investime në trajtimin ujërave të ndotura,
 - Investime në trajtimin dhe derdhjen e llumit, dhe
 - Investime në aktivitete biznesore

Investimet në asetet e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura ndahen në: **asete të infrastrukturës dhe ato të jo-infrastrukturës**

Investimet kapitale në **Asetet Infrastrukturore** janë të ndara në investime: (i) të cilat bëhen për qëllime të përtëritjes infrastrukturës, (ii) dhe në investime të rritjes së infrastrukturës. Këto Investime karakterizohen si investime në asetet nëntokësore siç janë: gypat, pusetat, digat, rezervuarët nëntokësor, kanalet e ujit etj.

Investimet kapitale në **Asetet Jo-Infrastrukturore** bëjnë pjesë të gjitha investimet në asetet mbitokësore: (i) fabrikat për trajtimin e ujit, (ii) ndërtesat administrative, (iii) mjetet transportuese, (iv) pajisjet për zyrë etj. Ky grup i investimeve mandej kategorizohet në investime të mirëmbajtjes kapitale dhe rritjes së jo-infrastrukturore.

5.3.3 Ndikimi i investimeve në tarifa

Nga figura 5 u shpalesën kategoritë e investimeve në infrastrukturën e ujit, kësaj kategorie duhet shtuar edhe një kategori e investimeve në aktivitete biznesore dhe me këtë fitohet pasqyra e përgjithshme e kategorive të investimeve kapitale me rastin e kalkulimit të tarifave.

Me qëllim që të ruhet niveli i shërbimit me tarifa sa më të arsyeshme dhe të përballueshme, kategori të ndryshme të investimeve kapitale kanë ndikime të ndryshme në tarifa.

Kategoria e cila ka ndikim direkt në tarifa është ajo e përtërimit të infrastrukturës. Prandaj edhe në parimet e vendosura nga ARRU për shtrirje dhe shpërndarje të investimeve, është kërkuar që në totalin e investimeve kapitale rreth gjysma e tyre duhet të alokohen në përtërimit të infrastrukturës dhe në kategorinë e zëvendësimit të ujëmatësive. Kategoritë tjera të investimeve fillimisht i shtohen BRRRA-së, e pastaj u njihet zhvlerësimi dhe kthimi në kapital prej 4%.

Tabela 8. Investimet e aprovuara për shërbimet e ujit sipas kategorive

Kategoria e investimeve	Njësia	2022	2023	2024
Përtëritje e infrastrukturës	EUR/vit	1,905,298	2,010,298	1,612,206
Rritja e infrastrukturës	EUR/vit	380,600	602,000	748,000
Mirëmbajtja kap jo-infra	EUR/vit	1,228,414	1,113,414	1,285,414
Rritja jo-infra	EUR/vit	355,197	142,900	567,000
Aktivitete biznesore	EUR/vit	955,350	742,800	721,480
Totali	EUR/vit	4,824,859	4,611,412	4,934,100

Tabela 9. Investimet e aprovuara për shërbimet e ujërave të ndotura sipas kategorive

Kategoria e investimeve	Njësia	2022	2023	2024
Përtëritje e infrastrukturës	EUR/vit	818,653	799,517	775,660
Rritja e infrastrukturës	EUR/vit	2,000	20,000	50,000
Mirëmbajtja kap jo-infra	EUR/vit	231,075	137,375	568,360
Rritja jo-infra	EUR/vit	0	0	0
Aktivitete biznesore	EUR/vit	122,889	186,900	94,000
Totali	EUR/vit	1,174,617	1,143,792	1,488,020

Në figurën 6 dhe 7 pasqyrohet përqindja e pjesëmarrjes së kategorive të ndryshme të investimeve kapitale, për ujë dhe ujëra të ndotura, të aprovuara për procesin tarifor 2022-2024, si mesatare e viteve 2022-2024.




Figura 6. Alokimi i investimeve për ujë




Figura 7. Alokimi i investimeve për u.n

Në figurën 8 është prezantuar skema e thjeshtuar e ndarjes së asetëve mbi nivelin tokës dhe nën nivelin e tokës, me përshkrime përcjellëse të referuar udhëzimeve të kontabilitetit rregullator.




Figura 8. Kategorizimi i asetëve sipas udhëzimeve të kontabilitetit rregullator

5.4 Numri i konsumatorëve

Spektori ka planifikuar që në vitin e parë të procesi tarifor të ketë 435,996 konsumatorë për shërbimet e ujësjellësit dhe 348,816 konsumatorë për shërbimet e ujërave të ndotura.

Trendi i planifikimeve të bazës së konsumatorëve ka qenë dhe është gjithnjë në rritje, ku për shërbimet e ujësjellësit në fund të vitit 2024 janë planifikuar të jenë 466,512 konsumatorë, rritje kjo në masën prej 7% kur krahasohet me vitin 2022, kurse për ujëra të ndotura në fund të vitit 2024 janë planifikuar të jenë 379,697 konsumatorë, e cila është rritje prej 9% krahasuar me vitin 2022.




Figura 9. Konsumatorët

Paralelisht me rritjen e numrit të konsumatorëve janë rritur edhe shitjet e ujit si dhe ka pasur edhe rritje të shpenzimeve operative pas analizave dhe sfidimeve të aplikuara nga ARRU.

Analizuar në vlera mesatare, KRU-ja e cila ka numrin më të madh të konsumatorëve është KRU “Prishtina” e cila përbën 37% të konsumatorëve në nivel të sektorit, me rreth 168,000 konsumatorë si mesatare për vitet 2022-2024, kurse KRU-ja e cila ka numrin më të vogël të konsumatorëve në Kosovë është KRU “Bifurkacioni” me rreth 38,000 konsumatorë si mesatare për vitet 2022-2024, e cila përbën 8% të bazës së konsumatorëve në Kosovë.

5.5 Faturimi dhe shkalla e arkëtimit

Si rezultat i rritjes së planifikuar të bazës së konsumatorëve, sektori ka planifikuar edhe rritje të faturimit në njësi vëllimore dhe në vlerë financiare. Sidomos këtij relacioni ARRU i ka kushtuar rendësi të veçantë në mënyrë që paralelisht me rritjen e numrit të konsumatorëve të reflektohet edhe rritja e faturimit e cila do të balanconte dhe do të rriste efikasitetin e KRU-së në aspektin e menaxhimit të shpenzimeve operative.

Vlera e planifikimeve të faturimit për vitin 2022 është rreth 41.5 milion Euro, kurse në vitin 2024 është planifikuar që të rritet në 44.5 milion euro, pra kemi të bëjmë me një rritje prej rreth 3 milion euro, që shprehur në përqindje kjo rritje kap vlerën prej 7% e cila korrespondon me rritjen e numrit të konsumatorëve.

Tabela 10. Planifikimi i faturimit në procesin tarifor 2022-2024

Kategoria e faturimit	Njësia	2022	2023	2024
Faturimi për ujë	EUR/vit	35,067,146	36,335,146	37,376,559
Faturimi për ujëra të ndotur	EUR/vit	6,487,623	6,800,131	7,040,402
Totali	EUR/vit	41,554,769	43,135,277	44,416,961

Përderisa tarifata e shërbimeve të kanalizimit janë më të ulëta në krahasim me shërbimet e ujësjellësit, po ashtu duke pasur parasysh se edhe mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit është më e vogël, sigurisht se edhe vlera e faturimit është më e vogël. Shikuar në vlera mesatare vjetore, faturimi për

shërbimet e ujit është 84% kurse për ujëra të ndotura është 16%. Ky proporcion pritet të ndryshojë në vitet pasuese, me rastin kur të futen në operim ITUN nëpër qendrat e mëdha urbane.

Në këtë proces tarifor është aprovuar që pragu i shkallës së arkëtimit të jetë si në vijim:

- Për konsumatorët shtëpiak 92%,
- Për konsumatorët biznes/ industri/ institucione 100%.




Figura 10. Alokimi i faturimit




Figura 11. Konsumatorët sipas KRU-ve

Përfundimisht nga ky rregull bën vetëm KRU Mitrovica, që për shkak të situatës aktuale politike dhe gjendjes sociale të rënduar të qytetarëve, arkëtimi është aprovuar të jetë 81%-83%-84% për periudhën 2022-2023-2024, ndërsa për biznese/ industri/ institucione shkalla e arkëtimit është aprovuar të jetë 100%.

6 PËRBALLUESHMËRIA E TARIFAVE

Analiza për përballueshmërinë e pagesës së faturës së ujit dhe ujërave të ndotura ka ardhur si kërkesë e diskutimeve intensive aktuale në Kosovë të nxitura pas shtrenjtimit të kostos së energjisë dhe kostos së produkteve të tjera të konsumit. I tëri ky debat ka përkuar me procesin e rregullt të rishikimit tarifor (2022-2024) për shërbimet e ujit të cilin ARRU, në kuadër të mandatit të vet ligjor, e kishte iniciuar që nga mesi i vitit 2021, shumë më herët se të aktualizohej ngritja e kostos së energjisë dhe produkteve të tjera.

Kjo analizë do të tregojë sa është pjesëmarrja e faturës për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotur në koston e përgjithshme mujore të një familje me pagë mesatare në Kosovë. Në të njëjtën kohë, përmes kësaj analize, ARRU do të argumentojë dhe faktojë nevojën për rishikim të tarifave për këto shërbime, në mënyrë që të ruhet qëndrueshmëria financiare dhe operative e KRU-ve në Kosovë. ARRU po ashtu do të tregojë që mirëqenia e qytetarëve, përballueshmëria e pagesës së faturave dhe mirëmbajtja e standardeve të shërbimit të ujit dhe ujërave të ndotur nga ofruesit e shërbimeve janë dy faktorë shumë të rëndësishëm gjatë një procesi tarifor.

Palët e interesit për ujë dhe ujëra të ndotura në Kosovë, duke pasur parasysh gjendjen socio-ekonomike dhe trendin e shtrenjtimit të gjitha produkteve, kanë interes për të ditur nëse fatura mesatare mujore e një konsumatori shtëpiak është e përballueshme. Të gjitha KRU-të në Kosovë, përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të ujit dhe ujërave të ndotur, në regjistrat e tyre evidentojnë 25,514 konsumatorë si përfitues të ndihmave sociale, të cilët janë të liruar nga pagesa për ujë dhe ujëra të ndotur, këto fatura të papaguara nuk kompensohen nga Qeveria e Kosovës. Në vitin 2021, sipas publikimeve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, nga skema e ndihmës sociale kanë përfituar 25,514 familje. Kjo kategori përbën 6.4 % të numrit të konsumatorëve në Kosovë që marrin shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotur nga KRU-të e licencuara.

Kosova në rajon renditet si vendi i fundit për Bruto Produktin Vendor për kokë banori¹. Kjo edhe më shumë e ka nxitur ARRU-në që të hartojë një analizë të tillë. Niveli i pagave mesatare në Kosovë (paga mesatare bruto dhe neto.) është një e dhënë e rëndësishme, jo vetëm për institucionet e pavarura rregullatore, njëherësh është edhe tregues shumë i rëndësishëm për të matur përballueshmërinë e faturës së konsumatorit.

Përballueshmëria e pagesës së faturës mujore për ujë dhe ujëra të ndotura, përkufizohet si mundësi ekonomike e konsumatorëve shtëpiak për të paguar faturën për shërbime të ujit dhe ujërave të ndotura, pa cenuar vlerën minimale të ekonomive familjare për të konsumuar shërbime/ mallra të tjera të nevojshme.

Rezoluta e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Njeriut të datës 24 mars 2011, rekomandon që lartësia e faturës së ujit nuk duhet të tejkalojë 5% të ardhurave mesatare mujore familjare. Duke qenë se të dhënat e publikuara nga Agjencia për Statistika e Kosovës për pagë minimale, mesatare dhe maksimale janë për vitin 2021, atëherë analiza e përballueshmërisë do të bazohet në të dhënat për pagë mesatare të vitit 2021, ndërsa ngarkesa e faturës do të kalkulohet sipas tarifave të vitit 2022-2024.

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (WHO), janë të nevojshme nga 50 deri 100 litra për person në ditë në mënyrë që të plotësohen nevojat elementare, ndërsa sipas Bankës Botërore minimumi i nevojshëm i dhënies falas të sasisë së ujit për rastet sociale është 20 litra/ditë. Megjithatë, përballueshmëria është më e perceptueshme nga konsumatori nëse fatura shprehet në vlerë monetare, të cilën duhet ta paguajë konsumatori shtëpiak.

¹ Raporti i ASK - Bruto Produkti Vendor-2021-TM3, (<http://askada.rks-gov.net>)

Në tabelën numër 11, është prezantuar vlera e përgjithshme e faturës për shërbime të ujit dhe ujëra të ndotur për KRU-të individuale dhe mesatarja për sektorin e ujit për vitin 2021 dhe për vitin 2022, nën supozimin se një familje mesatare konsumon afërsisht 20 m³/muaj. Paga mesatare për vitin 2021 që ka qenë 484 Euro është aprovuar edhe për vitin 2022, pasi për vitin 2022 Agjencia e Statistikave të Kosovës ende nuk ka publikuar pagën mesatare.

Tabela 11. Përballueshmëria e faturave të shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura

KRU	Gjithsej ngarkesa e faturës	Lartësia e pagës bruto (2021)	Përballueshmëria (%)	Gjithsej ngarkesa e faturës	Lartësia e pagës bruto (2022)	Përballueshmëria (%)
PRN	11.45	484	2.36 %	11.88	484	2.45 %
MIT	10.37		2.14 %	10.80		2.23 %
GJA	10.58		2.18 %	12.10		2.50 %
PZ	12.31		2.54 %	12.31		2.54 %
PE	7.99		1.65 %	9.50		1.96 %
FE	10.80		2.23 %	11.23		2.32 %
GJI	10.15		2.09 %	10.37		2.14 %
Spektori	10.58		2.18 %	10.80		2.23 %

Është e qartë se tek të gjitha KRU-të përballueshmëria e pagesës së faturës për shërbimet e ujit për vitin 2022 (me tarifën e reja të aprovuara) nuk cenohet. Raporti midis vlerës së faturës ndaj pagës mesatare është në të gjitha KRU-të më i vogël se 2.54% të KRU “Hidroregjioni Jugor” – Prizren, më e ulëta nga të gjitha është për KRU “Hidrodrini” me pjesëmarrje prej 1.96%, ndërsa mesatarja e sektorit është 2.23%.

Bazuar në këto vlera, tarifën për shërbimet e ujit në Kosovë vlerësohen të jenë të përballueshme, pasi në një ekonomi familjare mund të ketë më tepër se një të punësuar, madje të ketë edhe burime të tjera të të ardhurave. Mund të thuhet se tarifën për shërbimet e ujit vlerësohen të jenë relativisht të ulëta, KRU-të nuk janë ende në gjendje të investojnë shuma të nevojshme në infrastrukturën e ujit dhe ujërave të ndotur, për pasojë investimet në infrastrukturë ende bazohen në subvencione nga Qeveria e Kosovës apo edhe nga donatorët.

SH-1.SHTOJCAT E RAPORTIT

SH-1.1. Të dhënat operative

Projeksioni për prodhimin e ujit, faturimin, dhe UPF për secilën KRU janë përmbledhur në tabelën 1.1.

Tabela 1.1. Të dhënat operative

KRU	Të dhënat	njësia	2022	2023	2024
PR	Uji i prodhuar	m ³ /vit	56,212,597	53,331,757	50,783,368
	Uji i humbur	m ³ /vit	30,293,914	27,144,201	24,293,522
	Uji i Faturuar	m ³ /vit	25,918,683	26,187,556	26,489,846
	% e ujit te humbur	%	53.9%	50.9%	47.8%
PZ	Uji i prodhuar	m ³	18,429,755	18,463,049	18,600,441
	Uji i humbur	m ³	9,392,657	8,863,635	8,558,026
	Uji i Faturuar	m ³	9,037,098	9,599,415	10,042,415
	% e ujit t[humbur	%	51.0%	48.0%	46.0%
PE	Uji i prodhuar	m ³	23,779,771	23,726,876	23,184,851
	Uji i humbur	m ³	13,502,000	12,900,000	12,000,000
	Uji i Faturuar	m ³	10,277,771	10,826,876	11,184,851
	% e ujit te humbur	%	56.8%	54.4%	51.8%
MIT	Uji i prodhuar	m ³	24,853,283	24,512,885	23,783,890
	Uji i humbur	m ³	12,185,533	11,412,885	10,483,890
	Uji i Faturuar JUG	m ³	7,867,750	8,300,000	8,500,000
	Uji i Faturuar VERI	%	4,800,000	4,800,000	4,800,000
	Total Faturimi	m ³	12,667,750	13,100,000	13,300,000
	% e ujit te humbur		49.0%	46.6%	44.1%
GJA	Uji i prodhuar	m ³	15,324,899	15,595,903	15,824,028
	Uji i humbur	m ³	5,774,785	5,643,674	5,489,461
	Uji i Faturuar	m ³	9,550,114	9,952,229	10,334,566
	% e ujit te humbur	%	37.7%	36.2%	34.7%
FE	Uji i prodhuar	m ³	10,265,765	9,878,279	9,433,810
	Uji i humbur	m ³	6,128,176	5,495,400	4,875,070
	Uji i Faturuar	m ³	4,137,589	4,382,879	4,558,740
	% e ujit te humbur	%	59.7%	55.6%	51.7%
GJI	Uji i prodhuar	m ³	7,702,037	7,854,741	8,020,062
	Uji i humbur	m ³	3,322,772	3,232,781	3,141,397
	Uji i Faturuar	m ³	4,379,265	4,621,960	4,878,665
	% e ujit te humbur	%	43.1%	41.2%	39.2%
SEKTORI	Uji i prodhuar	m ³	150,844,560	150,865,911	150,205,369
	Uji i humbur	m ³	74,876,291	72,194,997	69,416,286
	Uji i Faturuar	m ³	75,968,269	78,670,913	80,789,083
	% e ujit te humbur	%	49.6%	47.9%	46.2%

SH-1.2. Të dhënat për numrin e konsumatorëve

Të dhënat për numrin e konsumatorëve për secilën KRU veçmas janë përmbledhur në tabelën 1.2.

Tabela 1.2. Të dhënat për numrin e konsumatorëve

KRU	Të dhënat	njësia	2022	2023	2024
PR	Nr. i konsumatorë për shërbimet e ujësjellësit në fund të vitit	nr/vit	161,589	169,740	174,242
	Nr. i konsumatorë për shërbimet e ujërave të ndotura në fund të vitit	nr/vit	145,505	152,687	160,731
PZ	Nr. i konsumatorë për shërbimet e ujësjellësit në fund të vitit	nr/vit	56,620	61,097	61,586
	Nr. i konsumatorë për shërbimet e ujërave të ndotura në fund të vitit	nr/vit	52,717	54,863	57,700
PE	Nr. i konsumatorë për shërbimet e ujësjellësit në fund të vitit	nr/vit	54,142	55,644	57,195
	Nr. i konsumatorë për shërbimet e ujërave të ndotura në fund të vitit	nr/vit	27,654	28,695	29,745
MIT	Nr. i konsumatorë për shërbimet e ujësjellësit në fund të vitit	nr/vit	43,170	43,464	43,646
	Nr. i konsumatorë për shërbimet e ujërave të ndotura në fund të vitit	nr/vit	28,995	28,995	28,997
GJA	Nr. i konsumatorë për shërbimet e ujësjellësit në fund të vitit	nr/vit	45,742	47,534	49,326
	Nr. i konsumatorë për shërbimet e ujërave të ndotura në fund të vitit	nr/vit	30,219	31,421	32,624
FE	Nr. i konsumatorë për shërbimet e ujësjellësit në fund të vitit	nr/vit	37,005	38,226	40,086
	Nr. i konsumatorë për shërbimet e ujërave të ndotura në fund të vitit	nr/vit	32,138	33,111	34,919
GJI	Nr. i konsumatorë për shërbimet e ujësjellësit në fund të vitit	nr/vit	37,728	39,071	40,431
	Nr. i konsumatorë për shërbimet e ujërave të ndotura në fund të vitit	nr/vit	31,587	33,241	34,982
SEKTORI	Nr. i konsumatorë për shërbimet e ujësjellësit në fund të vitit	nr/vit	435,996	454,775	466,512
	Nr. i konsumatorë për shërbimet e ujërave të ndotura në fund të vitit	nr/vit	348,816	363,012	379,697

SH-1.3. Shpenzimet operative për ujë

Të dhënat për shpenzimet operative për ujë për secilën KRU, veçmas janë përmbledhur në tabelën 1.3.

Tabela 1.3. Shpenzimet operative për ujë

KRU	Të dhënat	njësia	2022	2023	2024
PR	Resurse dhe trajtim	EUR/vit	3,050,619	3,203,150	3,363,307
	Distribuim	EUR/vit	2,230,937	2,335,702	2,445,706
	Aktivite Biznesore	EUR/vit	4,674,864	5,066,107	5,187,145
	Totali	EUR/vit	9,956,420	10,604,959	10,996,158
PZ	Resurse dhe trajtim	EUR/vit	1,719,691	1,788,479	1,860,018
	Distribuim	EUR/vit	930,246	967,456	1,006,154
	Aktivite Biznesore	EUR/vit	815,770	848,401	882,337
	Totali	EUR/vit	3,465,707	3,604,335	3,748,509
PE	Resurse dhe trajtim	EUR/vit	187,380	196,700	226,700
	Distribuim	EUR/vit	1,964,000	2,060,700	2,222,000
	Aktivite Biznesore	EUR/vit	190,100	199,200	208,400
	Totali	EUR/vit	2,341,480	2,456,600	2,657,100
MIT	Resurse dhe trajtim	EUR/vit	1,829,198	1,846,344	1,863,662
	Distribuim	EUR/vit	619,082	868,499	886,422
	Aktivite Biznesore	EUR/vit	762,081	769,702	777,399
	Totali	EUR/vit	3,210,362	3,484,545	3,527,482
GJA	Resurse dhe trajtim	EUR/vit	376,977	376,977	376,977
	Distribuim	EUR/vit	866,372	866,372	866,372
	Aktivite Biznesore	EUR/vit	2,249,150	2,249,150	2,249,150
	Totali	EUR/vit	3,492,499	3,492,499	3,492,499
FE	Resurse dhe trajtim	EUR/vit	657,586	657,586	657,586
	Distribuim	EUR/vit	482,643	482,643	482,643
	Aktivite Biznesore	EUR/vit	529,492	529,492	529,492
	Totali	EUR/vit	1,669,721	1,669,721	1,669,721
GJI	Resurse dhe trajtim	EUR/vit	635,778	635,779	635,780
	Distribuim	EUR/vit	385,193	385,193	385,193
	Aktivite Biznesore	EUR/vit	675,106	675,106	675,106
	Totali	EUR/vit	1,696,077	1,696,078	1,696,079
SEKTORI	Resurse dhe trajtim	EUR/vit	8,457,229	8,705,015	8,984,030
	Distribuim	EUR/vit	7,478,474	7,966,565	8,294,490
	Aktivite Biznesore	EUR/vit	9,896,562	10,337,158	10,509,028
	Totali	EUR/vit	25,832,265	27,008,737	27,787,548

SH-1.4. Shpenzimet operative për ujëra të ndotura

Të dhënat për shpenzimet operative të ujërave të ndotura për secilën KRU veçmas janë përmbledhur në tabelën 1.4.

Tabela 1.4. Shpenzimet operative për ujëra të ndotura

KRU	Të dhënat	njësia	2022	2023	2024
PR	Grumbullim	EUR/vit	92,214	96,825	101,666
	Trajtim i UN	EUR/vit	19,014	19,965	20,963
	Trajtim i llumit	EUR/vit	-	-	-
	Aktivitete Biznesore	EUR/vit	973,603	1,027,283	978,647
	Totali	EUR/vit	1,084,831	1,144,072	1,101,276
PZ	Grumbullim	EUR/vit	641,882	607,164	622,563
	Trajtim i UN	EUR/vit	258,734	258,734	258,734
	Trajtim i llumit	EUR/vit	215,324	215,324	215,324
	Aktivitete Biznesore	EUR/vit	39,998	39,998	39,998
	Totali	EUR/vit	1,155,938	1,121,220	1,136,619
PE	Grumbullim	EUR/vit	474,300	497,700	514,800
	Trajtim i UN	EUR/vit	-	-	-
	Trajtim i llumit	EUR/vit	290,909	306,320	299,068
	Aktivitete Biznesore	EUR/vit	47,550	50,300	53,150
	Totali	EUR/vit	812,759	854,320	867,018
MIT	Grumbullim	EUR/vit	124,124	125,365	126,619
	Trajtim i UN	EUR/vit	59,248	59,841	60,439
	Trajtim i llumit	EUR/vit	41,341	51,631	52,521
	Aktivitete Biznesore	EUR/vit	84,637	85,484	86,339
	Totali	EUR/vit	309,350	322,320	325,918
GJA	Grumbullim	EUR/vit	109,643	118,412	127,204
	Trajtim i UN	EUR/vit	421,740	422,830	424,700
	Trajtim i llumit	EUR/vit	95,647	95,647	95,647
	Aktivitete Biznesore	EUR/vit	121,506	122,274	123,064
	Totali	EUR/vit	748,536	759,163	770,616
FE	Grumbullim	EUR/vit	188,730	196,279	204,130
	Trajtim i UN	EUR/vit	-	-	-
	Trajtim i llumit	EUR/vit	-	-	-
	Aktivitete Biznesore	EUR/vit	89,256	92,826	96,539
	Totali	EUR/vit	277,986	289,105	300,669
GJI	Grumbullim	EUR/vit	114,171	120,222	126,595
	Trajtim i UN	EUR/vit	-	-	-
	Trajtim i llumit	EUR/vit	-	-	-
	Aktivitete Biznesore	EUR/vit	55,574	55,887	56,218
	Totali	EUR/vit	169,745	176,109	182,813
SEKTORI	Grumbullim	EUR/vit	1,745,063	1,761,966	1,823,577
	Trajtim i UN	EUR/vit	758,737	761,370	764,836
	Trajtim i llumit	EUR/vit	643,221	668,922	662,560
	Aktivitete Biznesore	EUR/vit	1,412,124	1,474,051	1,433,955
	Totali	EUR/vit	4,559,144	4,666,309	4,684,928

SH-1.5. Faturimi

Të dhënat për faturimin për secilën KRU veçmas janë përmbledhur në tabelën 1.5.

Tabela 1.5. Faturimi

KRU	Të dhënat	njësia	2022	2023	2024
PR	Faturimi Ujë	EUR/vit	14,717,377	14,959,850	15,214,524
	Faturimi Kanalizim	EUR/vit	1,758,642	1,793,040	1,835,399
	Totali	EUR/vit	16,476,019	16,752,890	17,049,923
PZ	Faturimi Ujë	EUR/vit	4,401,153	4,669,478	4,868,749
	Faturimi Kanalizim	EUR/vit	1,386,343	1,437,355	1,498,834
	Totali	EUR/vit	5,787,496	6,106,833	6,367,583
PE	Faturimi Ujë	EUR/vit	3,546,297	3,714,437	3,834,861
	Faturimi Kanalizim	EUR/vit	977,251	1,039,561	1,092,107
	Totali	EUR/vit	4,523,548	4,753,998	4,926,968
MIT	Faturimi Ujë	EUR/vit	3,621,687	3,780,411	3,853,362
	Faturimi Kanalizim	EUR/vit	623,207	643,885	644,924
	Totali	EUR/vit	4,244,894	4,424,296	4,498,287
GJA	Faturimi Ujë	EUR/vit	4,578,209	4,772,622	4,957,019
	Faturimi Kanalizim	EUR/vit	1,003,082	1,103,194	1,142,919
	Totali	EUR/vit	5,581,292	5,875,816	6,099,938
FE	Faturimi Ujë	EUR/vit	2,084,083	2,204,247	2,291,137
	Faturimi Kanalizim	EUR/vit	408,114	428,444	445,766
	Totali	EUR/vit	2,492,197	2,632,691	2,736,904
GJI	Faturimi Ujë	EUR/vit	2,118,341	2,234,101	2,356,906
	Faturimi Kanalizim	EUR/vit	330,984	354,653	380,452
	Totali	EUR/vit	2,449,324	2,588,753	2,737,358
SEKTORI	Faturimi Ujë	EUR/vit	35,067,146	36,335,146	37,376,559
	Faturimi Kanalizim	EUR/vit	6,487,623	6,800,131	7,040,402
	Totali	EUR/vit	41,554,769	43,135,277	44,416,961

SH-1.6. Arkëtimi

Të dhënat për arkëtimin për secilën KRU veçmas janë përmbledhur në tabelën 1.6.

Tabela 1.6. Arkëtimi

KRU	Të dhënat	njësia	2022	2023	2024
PR	Arkëtimi Ujë	EUR/vit	13,849,568	14,084,575	14,328,808
	Arkëtimi Kanalizim	EUR/vit	1,669,846	1,703,956	1,744,381
	Totali	EUR/vit	15,519,414	15,788,531	16,073,188
PZ	Arkëtimi Ujë	EUR/vit	4,117,056	4,365,484	4,549,031
	Arkëtimi Kanalizim	EUR/vit	1,305,127	1,352,696	1,409,313
	Totali	EUR/vit	5,422,182	5,718,180	5,958,344
PE	Arkëtimi Ujë	EUR/vit	3,339,815	3,497,563	3,611,410
	Arkëtimi Kanalizim	EUR/vit	934,268	993,627	1,044,248
	Totali	EUR/vit	4,274,082	4,491,190	4,655,658
MIT	Arkëtimi Ujë	EUR/vit	3,085,211	3,273,003	3,369,377
	Arkëtimi Kanalizim	EUR/vit	547,515	572,363	577,017
	Totali	EUR/vit	3,632,726	3,845,366	3,946,394
GJA	Arkëtimi Ujë	EUR/vit	4,327,517	4,511,361	4,685,883
	Arkëtimi Kanalizim	EUR/vit	950,012	1,048,961	1,086,522
	Totali	EUR/vit	5,277,529	5,560,322	5,772,405
FE	Arkëtimi Ujë	EUR/vit	1,944,983	2,056,421	2,137,074
	Arkëtimi Kanalizim	EUR/vit	382,694	401,662	417,822
	Totali	EUR/vit	2,327,677	2,458,084	2,554,896
GJI	Arkëtimi Ujë	EUR/vit	1,980,110	2,090,024	2,206,912
	Arkëtimi Kanalizim	EUR/vit	311,154	333,588	358,077
	Totali	EUR/vit	2,291,264	2,423,612	2,564,989
SEKTORI	Arkëtimi Ujë	EUR/vit	32,644,259	33,878,431	34,888,494
	Arkëtimi Kanalizim	EUR/vit	6,100,616	6,406,854	6,637,380
	Totali	EUR/vit	38,744,874	40,285,285	41,525,874

SH-1.7. Investimet kapitale vetjake për ujë

Të dhënat për investimet kapitale për secilën KRU veçmas janë përmbledhur në tabelën 1.7.

Tabela 1.7. Investimet kapitale vetjake për ujë

KRU	Të dhënat	njësia	2022	2023	2024
PR	Përtëritje e infrastrukturës	EUR/vit	576,000	576,000	576,000
	Rritja e infrastrukturës	EUR/vit	20,000	20,000	20,000
	Mirëmbajtja kap jo-infra	EUR/vit	367,600	352,600	352,600
	Rritja jo-infra	EUR/vit	165,000	0	350,000
	Aktivitete biznesore	EUR/vit	434,500	327,000	318,000
	Totali	EUR/vit	1,563,100	1,275,600	1,616,600
PZ	Përtëritje e infrastrukturës	EUR/vit	210,000	190,000	50,000
	Rritja e infrastrukturës	EUR/vit	164,200	350,000	480,000
	Mirëmbajtja kap jo-infra	EUR/vit	10,000	0	0
	Rritja jo-infra	EUR/vit	97,000	73,500	122,000
	Aktivitete biznesore	EUR/vit	100,000	40,000	25,000
	Totali	EUR/vit	581,200	653,500	677,000
PE	Përtëritje e infrastrukturës	EUR/vit	395,000	520,000	310,500
	Rritja e infrastrukturës	EUR/vit	0	22,000	48,000
	Mirëmbajtja kap jo-infra	EUR/vit	150,000	65,000	227,000
	Rritja jo-infra	EUR/vit	0	59,400	80,000
	Aktivitete biznesore	EUR/vit	110,000	0	0
	Totali	EUR/vit	655,000	666,400	665,500
MIT	Përtëritje e infrastrukturës	EUR/vit	200,000	200,000	200,000
	Rritja e infrastrukturës	EUR/vit	0	0	0
	Mirëmbajtja kap jo-infra	EUR/vit	190,000	190,000	190,000
	Rritja jo-infra	EUR/vit	0	0	0
	Aktivitete biznesore	EUR/vit	0	0	0
	Totali	EUR/vit	390,000	390,000	390,000
GJA	Përtëritje e infrastrukturës	EUR/vit	233,592	233,592	185,000
	Rritja e infrastrukturës	EUR/vit	171,400	200,000	200,000
	Mirëmbajtja kap jo-infra	EUR/vit	242,000	159,000	159,000
	Rritja jo-infra	EUR/vit	93,197	10,000	15,000
	Aktivitete biznesore	EUR/vit	247,850	375,800	378,480
	Totali	EUR/vit	988,039	978,392	937,480
FE	Përtëritje e infrastrukturës	EUR/vit	130,000	130,000	130,000
	Rritja e infrastrukturës	EUR/vit	25,000	10,000	0
	Mirëmbajtja kap jo-infra	EUR/vit	93,990	171,990	181,990
	Rritja jo-infra	EUR/vit	0	0	0
	Aktivitete biznesore	EUR/vit	63,000	0	0
	Totali	EUR/vit	311,990	311,990	311,990
GJI	Përtëritje e infrastrukturës	EUR/vit	160,706	160,706	160,706
	Rritja e infrastrukturës	EUR/vit	0	0	0
	Mirëmbajtja kap jo-infra	EUR/vit	174,824	174,824	174,824
	Rritja jo-infra	EUR/vit	0	0	0
	Aktivitete biznesore	EUR/vit	0	0	0
	Totali	EUR/vit	335,530	335,530	335,530
SEKTORI	Përtëritje e infrastrukturës	EUR/vit	1,905,298	2,010,298	1,612,206
	Rritja e infrastrukturës	EUR/vit	380,600	602,000	748,000
	Mirëmbajtja kap jo-infra	EUR/vit	1,228,414	1,113,414	1,285,414
	Rritja jo-infra	EUR/vit	355,197	142,900	567,000
	Aktivitete biznesore	EUR/vit	955,350	742,800	721,480
	Totali	EUR/vit	4,824,859	4,611,412	4,934,100

SH-1.8. Investimet kapitale vetjake për ujëra të ndotura

Të dhënat për investimet vetjake për ujëra të ndotura për secilën KRU janë përmbledhur në tabelën 1.8.

Tabela 1.8. Investimet vetjake për ujëra të ndotura

KRU	Të dhënat	njësia	2022	2023	2024
PR	Përtëritje e infrastrukturës	EUR/vit	195,000	195,000	195,000
	Rritja e infrastrukturës	EUR/vit	0	0	0
	Mirëmbajtja kap jo-infra	EUR/vit	50,000	0	370,000
	Rritja jo-infra	EUR/vit	0	0	0
	Aktivite biznesore	EUR/vit	45,500	33,000	32,000
	Totali	EUR/vit	290,500	228,000	597,000
PZ	Përtëritje e infrastrukturës	EUR/vit	65,000	90,700	65,000
	Rritja e infrastrukturës	EUR/vit	2,000	20,000	50,000
	Mirëmbajtja kap jo-infra	EUR/vit	130,000	86,300	82,000
	Rritja jo-infra	EUR/vit	0	0	0
	Aktivite biznesore	EUR/vit	0	0	0
	Totali	EUR/vit	197,000	197,000	197,000
PE	Përtëritje e infrastrukturës	EUR/vit	110,616	114,780	118,980
	Rritja e infrastrukturës	EUR/vit	0	0	0
	Mirëmbajtja kap jo-infra	EUR/vit	0	0	0
	Rritja jo-infra	EUR/vit	0	0	0
	Aktivite biznesore	EUR/vit	0	0	0
	Totali	EUR/vit	110,616	114,780	118,980
MIT	Përtëritje e infrastrukturës	EUR/vit	150,000	150,000	150,000
	Rritja e infrastrukturës	EUR/vit	0	0	0
	Mirëmbajtja kap jo-infra	EUR/vit	0	0	0
	Rritja jo-infra	EUR/vit	0	0	0
	Aktivite biznesore	EUR/vit	0	0	0
	Totali	EUR/vit	150,000	150,000	150,000
GJA	Përtëritje e infrastrukturës	EUR/vit	134,000	134,000	134,000
	Rritja e infrastrukturës	EUR/vit	0	0	0
	Mirëmbajtja kap jo-infra	EUR/vit	0	0	0
	Rritja jo-infra	EUR/vit	0	0	0
	Aktivite biznesore	EUR/vit	65,389	73,900	62,000
	Totali	EUR/vit	199,389	207,900	196,000
FE	Përtëritje e infrastrukturës	EUR/vit	91,000	40,000	37,643
	Rritja e infrastrukturës	EUR/vit	0	0	0
	Mirëmbajtja kap jo-infra	EUR/vit	10,000	10,000	75,285
	Rritja jo-infra	EUR/vit	0	0	0
	Aktivite biznesore	EUR/vit	12,000	80,000	0
	Totali	EUR/vit	113,000	130,000	112,928
GJI	Përtëritje e infrastrukturës	EUR/vit	73,037	75,037	75,037
	Rritja e infrastrukturës	EUR/vit	0	0	0
	Mirëmbajtja kap jo-infra	EUR/vit	41,075	41,075	41,075
	Rritja jo-infra	EUR/vit	0	0	0
	Aktivite biznesore	EUR/vit	0	0	0
	Totali	EUR/vit	114,112	116,112	116,112
SEKTORI	Përtëritje e infrastrukturës	EUR/vit	818,653	799,517	775,660
	Rritja e infrastrukturës	EUR/vit	2,000	20,000	50,000
	Mirëmbajtja kap jo-infra	EUR/vit	231,075	137,375	568,360
	Rritja jo-infra	EUR/vit	0	0	0
	Aktivite biznesore	EUR/vit	122,889	186,900	94,000
	Totali	EUR/vit	1,174,617	1,143,792	1,488,020

SH-1.9. Tarifat finale 2022-2024

Të dhënat për tarifat përfundimtare, për secilën KRU, veçmas janë përmbledhur në tabelën 1.9.

Tabela 1.9. Tarifat e shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura për vitet 2022-2024

Kompania	Konsumatorët	Tarifat	Njësia	2022	2023	2024
PR	Shtëpiak	Ujësjellës	EUR/m ³	0.44	0.44	0.44
		Kanalizim	EUR/m ³	0.06	0.06	0.06
	Jo-shtëpiak	Ujësjellës	EUR/m ³	0.67	0.67	0.67
		Kanalizim	EUR/m ³	0.13	0.13	0.13
PZ	Shtëpiak	Ujësjellës	EUR/m ³	0.38	0.38	0.38
		Kanalizim	EUR/m ³	0.14	0.14	0.14
	Jo-shtëpiak	Ujësjellës	EUR/m ³	0.57	0.57	0.57
		Kanalizim	EUR/m ³	0.32	0.32	0.32
PE	Shtëpiak	Ujësjellës	EUR/m ³	0.25	0.25	0.25
		Kanalizim	EUR/m ³	0.14	0.14	0.14
	Jo-shtëpiak	Ujësjellës	EUR/m ³	0.37	0.37	0.37
		Kanalizim	EUR/m ³	0.31	0.31	0.31
MIT	Shtëpiak	Ujësjellës	EUR/m ³	0.36	0.36	0.36
		Kanalizim	EUR/m ³	0.09	0.09	0.09
	Jo-shtëpiak	Ujësjellës	EUR/m ³	0.54	0.54	0.54
		Kanalizim	EUR/m ³	0.20	0.20	0.20
GJA	Shtëpiak	Ujësjellës	EUR/m ³	0.37	0.37	0.37
		Kanalizim	EUR/m ³	0.14	0.14	0.14
	Jo-shtëpiak	Ujësjellës	EUR/m ³	0.56	0.56	0.56
		Kanalizim	EUR/m ³	0.30	0.30	0.30
FE	Shtëpiak	Ujësjellës	EUR/m ³	0.37	0.37	0.37
		Kanalizim	EUR/m ³	0.10	0.10	0.10
	Jo-shtëpiak	Ujësjellës	EUR/m ³	0.55	0.55	0.55
		Kanalizim	EUR/m ³	0.22	0.22	0.22
GJI	Shtëpiak	Ujësjellës	EUR/m ³	0.35	0.35	0.35
		Kanalizim	EUR/m ³	0.08	0.08	0.08
	Jo-shtëpiak	Ujësjellës	EUR/m ³	0.52	0.52	0.52
		Kanalizim	EUR/m ³	0.17	0.17	0.17
Mesatarja e thjeshte e sektorit		Ujësjellës	Ujësjellës	0.35	0.35	0.36
		Kanalizim	Kanalizim	0.08	0.09	0.11
		Ujësjellës	Ujësjellës	0.59	0.59	0.54
		Kanalizim	Kanalizim	0.17	0.19	0.24

PERSONAT KONTAKTUES PËR INFORMACIONE SHITESË RRETH RAPORTIT:

Refik Ramaj – Drejtor i Departamentit të Tarifave (Refik.ramaj@arru-rks.org)
Hysni Feka – Analist për tarifa dhe financa rregullatorë (hysni.feka@arru-rks.org)
Vehbi Duraku – Analist i Investimeve Kapitale (vehbi.duraku@arru-rks.org)

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT

Rr. Ali Pashë Tepelena, nr.01

Prishtinë, KOSOVË

Tel.:+ 383 38 24 91 65

<http://www.arru-rks.org>